

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org. 013 Nr. Prot: 2691
Org. Jedinica 013 Broj Prot: 2691
Org Unit 013 Prot. No: 2691
Nr. i faqeve 2 Data: 04, 08, 2015
Br. stranica 2 Datum: 04, 08, 2015
No. pages 2 Prishtinë / a



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku
i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology**

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister


Prishtinë, më 4 gusht 2015
Ref. nr: 231/013


Ministri i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të dispozitave të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), dispozitave të neneve 5 dhe 33 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare, nr. 17, 16 shtator 2011) dhe dispozitave të nenit 8 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Gazeta Zyrtare, Nr. 1, 18 prill 2011), merr këtë:

V E N D I M

1. Të diplomuarit në programet e licencuara të studimit për përgatitje të mësimdhënësve të ofruara nga Bartësit Privat të Arsimit të Lartë (BPrAL), të licencuara para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 04 /L-37 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 9 shtator 2011), konsiderohen të barabartë me të diplomuarit në programet e njëjta të ofruara nga universitetet publike.
2. Obligohet Departamenti për Arsim të Lartë të siguroj vendimet për licencim të BPrAL dhe listën me të dhënat e sakta të diplomuarve në programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit të siguroj listën me të dhënat e sakta të mësimdhënësve të punësuar, të diplomuar në programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Obligohet Departamenti i Inspeksionit të Arsimit të zbatoj procedurat e licencimit të mësimdhënësve për të diplomuarit në programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- 4.1. Të drejtën e aplikimit dhe licencimit e kanë të gjithë të diplomuarit në programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të punësuar apo në pritje për punësim si mësimdhënës;
5. Të gjithë mësimdhënësit e punësuar, të diplomuar në programet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, e vazhdojnë punën me kusht që të aplikojnë dhe pajisen me licencë, më së largu deri më 31 dhjetor 2015.
6. Obligohet Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar që të ua dërgojë këtë vendim të gjitha Drejtorie Komunale për Arsim.
7. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

 Prof. Dr. Arsim BAJRAMI, Ministër



Iu dërgohet:

- Të gjitha Drejtorive Komunale për Arsim;
- Sekretarit të Përgjithshëm të MASHT;
- Departamentit të Inspeksionit të Arsimit, MASHT;
- Departamenti për Arsimin e Lartë, MASHT;
- Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar;
- Arkivit të MASHT;